



Planuar / Doretuzat Primiçeno/Produato Received/Deliverty	01.02.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHOK	1212/2023		15



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1102/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1102/2022 të datës 05.12.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson

kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 01.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1102/2022 e datës 05.12.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi KD.nr.037/2022 i datës 28.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.
- III. Detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas Kontratës së marrëdhënies së punës të datës 05.07.2018, në pozitën "Zyrtar korrektues" në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar shkresat e lëndës lidhur me çështjen e ankuesit, ka konstatuar se ankuesi me datën 21.09.2022 përmes Vendimit me numër KD.nr.37/22 i nxjerrë nga Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, është pezulluar përkohësisht nga puna prej datës 22.09.2022. Tutje me datën 19.10.2022, Komisioni Disiplinor i Shërbimit korrektues të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër KD.nr.037/2022, sipas të cilit e ka shtyrë afatin për vendosjen e procedurës disiplinore ndaj ankuesit edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë, ndërsa pas kësaj me datën 28.10.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër KD.nr.037/2022 sipas së cilit e ka pezulluar procedurën disiplinore ndaj ankuesit, me arsyetimin se ndaj tij është hapur rast në Prokurori sipas numrit të lëndës PPN-nr-273/22 nën dyshimin për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe mbi këtë bazë ka vendosur lidhur me pezullimin e procedurës disiplinore deri në vendosjen e çështjes kryesore nga organi kompetent.

Ndërlidhur me rastin e ankuesit si dhe pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të tij mbi bazën e të cilave ka parashtruar ankesën në Këshill, Kolegji pasi ka analizuar Vendimin me numër KD.nr.037/2022 të datës 28.10.2022 i nxjerrë nga Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka konstatuar se i njëjti vendim bazën ligjore mbi të cilën ka vendosur lidhur me pezullimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, e ka mbështetur në nenin 55 paragrafin 1, nenin 58 paragrafin 4, nenin 56 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 48 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 13 paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Kolegji i Këshillit ka vlerësuar se vendimi KD.nr.037/2022 i datës 28.10.2022 i lëshuar nga ana e Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës e i atakuar me ankesë nga ana e ankuesit në Këshill, përmban disa shkelje ligjore duke u nisur fillimisht nga fakti se i njëjti vendim bazën ligjore e ka mbështetur në nenet të cilat e rregullojnë institutin e pezullimit të zyrtarit publikë e jo të pezullimit të një procedure disiplinore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore mbi bazën e të cilave është nxjerrë vendimi i kontestuar dhe ka vlerësuar se neni 55 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *"1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, i cili bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; apo 1.2. me kërkesë të nëpunësit civil"*, po ashtu neni 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *"1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji"*, ndërsa neni 58 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *"4. Nëpunësi civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.1 të nenit 56, në rast se procedura përfundon pa një masë disiplinore dhe në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.7 të nenit 56, nëpunësi përfiton 50 për qind të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtese në pagë për një periudhë pezullimi deri në 6 muaj"*, si dhe neni 13 paragrafi 6 i Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ka përcaktuar se: *"6. Komisioni disiplinor mund të vendos edhe pezullimin e marrëdhënies së punës së nëpunësit civil, nëse vlerëson se nëpunësi civil ndaj të cilit zhvillohet procedura disiplinore pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij"*. Andaj nisur nga dispozitat ligjore të analizuara si më lartë, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.037/2022 të datës 28.10.2022 lidhur me pezullimin e procedurës disiplinore për rastin e ankuesit, nuk ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe rrjedhimisht i njëjti është nxjerrë pa ndonjë bazë ligjore të specifikuar dhe që lidhet me objektin e vendimmarrjes konkrete, ngase i njëjti është kontradiktor ndërlidhur me mënyrën e vendosjes, për faktin se



është i bazuar në dispozita ligjore të cilat nuk rregullojnë fushën lidhur me pezullimin e një procedure disiplinore mirëpo dispozitat ligjore mbi bazën e të cilave është nxjerrë ky vendim i referohen në tërësi rastit të pezullimit të nëpunësit publikë. Po ashtu Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor me rastin e vendosjes së pezullimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, duke u bazuar vetëm në shkresën e datës 13/09/2022 nga zyra e Kryeprokurorit të Shtetit me numër të lëndës PPN.nr.273/22 lidhur me pranimin e njoftimit për rastin e ankuesit që lidhet me keqpërdorim të detyrës zyrtare nga ana e të njëjtit, pa pasur njoftim zyrtar nga kjo e fundit se ndaj ankuesit është nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve zyrtare lidhur me çështjen e kontestuar, nuk ka arritur të konstatoj në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike sa i përket vendimmarrjes që atakohet me këtë ankesë, e krejt kjo në kundërshtim me dispozitat e nenit 47 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 si dhe nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar shkresat e lëndës ndërlidhur me rastin e ankuesit, ka konstatuar se ndaj ankuesit për rastin e njëjtë Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës përmes Vendimit me numër Nr.0873 të datës 13.06.2017, kishte vendosur lidhur me lirimin e tij në mungesë të provave dhe fakteve për fajësinë disiplinore. Kolegji i Këshillit, vlerëson se çështja e pezullimit sipas detyrës zyrtare të zyrtarëve publik është e rregulluar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, i cili decidivisht precizon se: *"1.4. kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi"*, atëherë Komisioni Disiplinor për rastin konkret të ankuesit do duhej të zhvillojë dhe përfundoj procedurën disiplinore dhe mbi bazën e fakteve dhe provave ta trajtoj rastin e ankuesit dhe të vendos në mënyrë meritore, duke konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën ligjore si dhe duke marrë parasysh faktin se i njëjti bazuar në vendimin e potencuar si më lartë ishte liruar nga përgjegjësia disiplinore për të njëjtën çështje ,përkatësisht duke marrë parasysh të gjitha rrethanat që lidhen me rastin konkret administrativ.

Kështu që, duke qenë se Vendimi i atakuar me numër KD.nr.037/2022 i datës 28.10.2022, i Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoi që kjo çështja ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast tek Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj rastin e ankuesit dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh pikëpamjet juridike të dhëna nga Kolegji i Këshillit.

Kështu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1102/2022, datë 01.02.2023.

Ardita PERÇUKU-SHYTI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesi
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

